



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA “ECO – ELB” sh.a

Elbasan, më . . .2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS : “Blerje, Kontenier”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT: 2.000.000 (dymilion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **ECO-ELB Sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në **nenin 43** "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare" të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: "1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.."

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron

vjetore jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet bazuar në nenin 43 pika 2 e VKM-së.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Konkretisht në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës

2.3.2 Çertifikate personale e prodhuesit ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çerfikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit Kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që subjekti që i prodhon të provojë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

2.3.3 Çertifikate personale e prodhuesit ISO 14001:2015, te standartit nderkombetar i Menaxhimit te Mjedisit dhe /ose te njevlefshme,ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çerfikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë

15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”.

Kompania që është e pajisur me këto çertifikate, është e prirur në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke i mundur asaj të përmirësojë ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe të aplikojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i tij. Sistemet e menaxhimit mjedisor të bazuara në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim:

Parandalimi i dëmtimit të mjedisit;

Vlerësimi i aspekteve mjedisore;

Rritja e performancës mjedisore;

Respektimi i ligjeve;

Ruajtja e burimeve natyrore dhe reduktimi i kostos;

Përmirësimi i imazhit të kompanisë;

2.3.4 Çertifikate personale e prodhuesit ISO 45001:2018, të standartit ndërkombëtar të sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe /ose të njevlëshme, të cilat do t’u garantonin organizatave të ofrojnë vende pune të sigurta dhe të shëndetshme duke parandaluar dëmtimet dhe sëmundjet e lidhura me punën, ose standart ISO me e avancuar, ku të jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet të jene të vlefshme dhe të leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilet janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”, Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”.

ISO 45001:2018 i mundëson një organizatë, nëpërmjet sistemit të saj të menaxhimit, të integrojë aspekte të tjera të shëndetit dhe sigurisë, të tilla si shëndeti/mirëqenia e punëtorëve, vende pune të sigurta dhe të shëndetshme duke parandaluar dëmtimet dhe sëmundjet e lidhura me punën.

2.3.5 Çertifikate personale e prodhuesit sipas “Direktiva e tensionit të ulët (LVD) (2014/35/BE)” , të standartit ndërkombëtar i cili siguron që pajisjet elektrike brenda kufijve të caktuar të tensionit ofrojnë një nivel të lartë mbrojtjeje për qytetarët të shëndetit dhe sigurisë, dhe /ose të njevlëshme, ose standart ISO me e avancuar, ku të jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet të jene të vlefshme dhe të leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilet janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky

kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”, Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”.

Direktiva e tensionit të ulët (LVD) (2014/35/BE) siguron që pajisjet elektrike brenda kufijve të caktuar të tensionit ofrojnë një nivel të lartë mbrojtjeje për ata që e përdorin ato.

Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve dhe sigurinë e tyre në kantieret e përkohshme pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai mund të dëmtonte seriozisht jetën edhe shëndetin e përdoruesve.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose skede teknike me të dhënat teknike të miratuara nga prodhuesi për artikujt që oferton. Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DST. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DT për përputhshmërinë e tyre.

2.3.7. OE ofertues duhet të paraqesë deklaratë konformiteti/performance sipas standartit SSH/EN 14509:2013 për lenden e pare të ndertimit të kontenierit (panelit sandwich), ose ekuivalente, në mënyrë që të veretohet cilësia e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, « *Neni 44, Kërkesat e cilësive, pika 1* », me anë të këtij kriteri kërkohet që *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, Dhe pika 4 e këtij neni : Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.* Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi i mallrave specifike dhe me funksione mbrojtëse speciale pasi disa nga produktet garantojnë jetën e dhe shëndetin e punonjësve që do t’i përdorin, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve dhe sigurinë e tyre në kantieret e përkohshme pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai mund të dëmtonte seriozisht jetën edhe shëndetin e përdoruesve.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Po ashtu, Njësia e prokurimit referuar specifikës që kanë mallrat objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë **me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit**, të të gjithë artikujve në adresën e autoritetit kontraktor, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë se marrin përsipër të kryejnë furnizime të mallrave cilësore të kërkuar**, duke përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit për këtë prokurim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” (i ndryshuar), VKM nr.692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”, VKM nr.1053, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Kontenieret janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Ata garantojnë sigurinë e jetës dhe shëndetit në punë të punonjësve sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo standart në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit